



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI VLORE
ISMAIL QEMALI

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE

Nr. 186 Prot
Vlorë më 11.10.2023

SPITALI RAJONAL
FIER

Nr. 346 Prot
Vlorë më 19.10.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

midis

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

dhe

SPITALIT RAJONAL FIER

Nisur nga interesi i përbashkët për zhvillimin e aktiviteteve me karakter arsimor, kulturor, rekreativ, dhe praktika mësimore, konferenca të përbashkëta, duke vlerësuar kontributin e deritanishëm, palët bien dakort për ripërsëritjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimi midis

Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, institucion i Arsimit të Lartë publik me adresë: Lagja "Pavarësia", Rruga "Kosova", Nr.9400 Vlorë, Shqipëri, përfaqësuar nga Prof.Dr. Roland Zisi, Rector i Universitetit.

Dhe

Spitalit Rajonal Fier, me adresë: Lagja "I Maji", Rruga "Çamëria", Fier, përfaqësuar nga Znj. Nevila Shuke, Drejtore e Spitalit Rajonal Fier.

Neni 1

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe Spitali Rajonal Fier përcaktojnë dhe rregullojnë me këtë marrëveshje hapësirat dhe çështjet e bashkëpunimit të ndërsjelltë, si dhe format dhe mënyrat e zbatimit të saj.

Neni 2

Pjesët e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali"
- Shërbim i Patologjisë





- Shërbimi i Kirurgjisë
- Shërbimi i Pediatrisë
- Shërbimi Obstetrik-Gjinekologji
- Shërbimi Infektiv
- Shërbimi Urgjencës

Neni 3

Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në dy cikle studimi:

- Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor
- Cikli dytë i studimeve të nivelit Master (profesional dhe shkencor)
- Cikli i tretë i studimeve (studime doktorale dhe specializime afatgjata)

Neni 4

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara
- Praktika mësimore
- Praktika profesionale
- Projekte kërkimore klinike
- Detyrat e kursit mbi azhën e ekzaminimit të rasteve klinike

Neni 5

Format dhe mënyrat e bashkëpunimit do të përfshijnë:

- Vënien në dispozicion të personelit mjekësor dhe infermieror të spitalit për mësimdhënie në modulet e programeve mësimore të FSH.
- Angazhimin e studentëve të FSH në procedurat infermiore të institucionit (nga marrja e annezisë deri tek ndjekja e terapisë).
- Bashkëpunimin e pedagogëve të FSH, personelit mjekësor dhe infermieror të Spitalit, si dhe studentëve për realizimin e detyrave të kursit, projekteve klinike dhe kërkimit shkencor mjekësor.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, workshop-e).
- Sigurimin e ambienteve të përshtatshme brenda territorit të institucionit për realizimin e seancave mësimore të praktikave profesionale.

Neni 6

Secila palë e Marrëveshjes do të caktojë një person ndërlidhës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

Neni 7

Personeli akademik i Fakultetit të Shëndetit, studentët e programeve mësimore të FSH si dhe personeli mjekësor i Spitalit Rajonal Fier janë të detyruar të zbatojnë kushtet e kësaj kontrate, për të cilat është rënë dakort nga titullarët e dy institucioneve.





Neni 8

Të dyja palët nënshkruese janë dakort se do të informojnë njëra-tjetrën për të gjitha rrethanat e rëndësishme për realizimin e kësaj marrëveshje

Neni 9

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje institucionet nuk nënkuptojnë asnjë detyrim financiar

Neni 10

Amendamente të mundshme ose shtesa të kësaj marrëveshje do të formulohen dhe parashirohen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.

Neni 11

Institucionet bien dakort që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshesh të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e marrëveshjes.

Neni 12

Kjo marrëveshje qëndron në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit.

Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.

Kjo marrëveshje mund të zgjidhet nëse secili prej institucioneve paraqet 6 (gjashtë) muaj përpara një kërkesë me shkrim drejtuar institucionit partner.

Neni 13

Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit respektivë ligjorë të të dy institucioneve. Marrëveshja është hartuar në 2 (dy) ekzemplarë në gjuhën shqipe. Të gjitha tekstet janë njëjloj të vlefshme.

Vlorë më 11.10.2023

PËR
UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR
PROF. DR. ROLAND ZISI



PËR
SPITALIN RAJONAL
FIER

DREJTOR/E
ZNJ. NEVILA SHUKE

